Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	**21.11.2023**	**27.11.2023**	**2023/0904**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.11.2023, OE "ENG IDEA SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0904, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "ENG IDEA SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Hartimi i projektit per kolektoret kryesore te Qytetit te Prizrenit", me nr. të prokurimit: "622-22-2389-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrates: pune, furnizim, sherbim, vlera e parashikuar e kontrates: 100.000,00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0904 i dt:13.11.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur dispozitat e LPP ne Neni 1 Qëllimi;

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,

Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi,

Neni 55 Menyra e komunikimit,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve,

Neni 60 Kriteret për dhenjen e kontratës Neni 61 Tenderet e ulet jasht Normales,

Neni 68 Gjendja ekonomike dhe financiare.

AK, me date 23.10.2023 ka publikuar njoftimin per vendimin e AK-se lidhur me Anulimin e proceduren e prokurimit me titull: Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit-Rivleresim, me numer prokurimi 622-22—2389-2-2-1, njekohesisht AK ka ngarkuar ne sitemin e-prourimi edhe letrat standarde per Eleminim te OE -ve. Ne kemi lexuar me shume kujdes te gjithe materialin, njoftimin e vendimit dhe letrat standarde te te gjithe OE-ve dhe grupeve te OE-ve pjesmarrese ne kete aktivitet prokurimi. Kemi parashtruar Kërkese për Rivleresim pran AK-se me date 30.10.2023, por e njeta eshte refuzuar si e pabazuar nga AK me Vendim te dates 02.11.2023. Para se te paraqesim pretendimet tona lidhur me kete procedure te prokurimit po ju rikujtojme se kjo procedure e prokurimit ka filluar 28.03.2023.

Deri me tani AK me joseriozitetin e saj ndaj kesaj procedure te prokurimit ka nxjer hiq me pak se 6 vendime per shpërblim me kontrate te OE -ve te ndryshem te gjithe me shkelje ligjore te cilat jane deshnmuar ne te gjitha vendimet e me parshme te OSHP-se per kete procedure.

18.07.2022 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK.docx 15.08.2022 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK - 2.docx 19.12.2022 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK 3 12.01.2023 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK 4 06.02.2023 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK 5 10.07.2023 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK -5- Rivleresim.docx 23.10.2023 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK -6-Rivleresimi Anulim.docx

Pretendimi 1: Komisioni i AK Komuan e Prizrenit nuk i ka trajtuar ne menyre te barabart te gjithe OE ofertues duke shkelur keshtu Nenin 1,6 dhe 7 te LPP-se. Kjo duket qarte kur lexohen arsyet e eleminimit te Grupit OE ENG IDEA SH.P.K. & ARCH EMPIRE L.L.C. per arsyet si me poshtë:

AKS I ETIM

*[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzua*r] për këto arsye : **Ju mungojn**

. Një gjëodet te licencuar nga AKK. me jo më pak se 1 vite përvojë pune në profesi

d. Diploma, Licenca e lëshuar nga AKK, dëshmi mbi përvojën në punë kontrata e
e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. (komisioni ka konstatuar se lice
e skaduar ne kohen e njoftimit per kontrate)

4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori
Kontraktues duhet ose:

***4.6.3 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm,* të trajtoj tenderin njëjtë me tende**

- ***Nëse sqarimi nuk mjafton,* TË REFUZOJ TENDERIN dhe, ne përputhje me ne**
njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "*Nj*
***tenderit abnormalisht te ulet"*, brenda dy dite nga data e vendimit.**

1 Ne pozicionet

- ***Poz 2- Hartimi i projektit per kolektorin kryesore per ujrat atmosferik 0.***
- ***Poz 3 Projekti per rehabilitimin e gypave 0.05 euro***
- ***e ofertës tuaj te na jepni sqarime lidhur me këto pozicione to se si***
konsiderohen si teje te ulëta.

Pas kërkesave per sqarime të tenderit me date 28.09.2023 në letrën standanrde m
te ulet ju si OE jeni te eleminuar ku sipas nenit 61 te LPP , komisioni i v
prezantuara kane gene ne disa pozicione jo normalishte te ulëta .

Arsyeja 1: Kerkesa e AK sa i perket gjeodetit është plotesuar në përputhje të plotë me pershkrimin si me siper pika d) Nje gjeodet te licencuar nga AKK me jo me pak se 1 vite pervoje pune ne profesion pas diplomimit, por eshte plotesisht i pasakt konstatimi se ne kemi ofruar gjeodet qe nuk ploteson vitet e pervojes se kerkuar.Ne kemi ofruar 2 inxhinier te gjeodezise z.Fjoralb Alla dhe z.Ilir Gashi te dy inxhinieret i plotesojn kushtet me 1 vite pervoje pune pas diplomimin. Me daten 28.09.2023 na keni kerkuar kerkese per sqarim te tenderit si me poshte :

Të na silleni këto dokumente shtese; sipas vendimit te OSHP-se 2023-0504

. d. Një gjëodet te licencuar nga AKK.
Dëshmia; **d. Diploma, Licenca e lëshuar nga Agjencioni Katastral I Kosove, dëshmi mbi përvojën në punë kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. (sipas nenit 72.3 te LPP ju lutemi te na dergoni Licencen e kerkuar) Dëshmija duhet të ofrohet për Gjeodetin Ilir Gashi I cili ndodhet në listen tuaj të ofruar.**

Ne kemi hartuar pergjigjen sqaruese lidhur me dokumente shtese te kerkuara, me date 03.10.2023, po e bashkangjesim edhe me kete kerkese per rishqyrtim. Po ua rikujtojm edhe njeher se ingjinieri i gjeodezis z.Ilir Gashi është i licencuar qe nga 15.02.2017 qe do te thote me 6 vite pervoje pune pas licencimit. Z. Ilir Gashi eshte i licencuar dhe ka pervojen me te gjate se sa eshte kerkuar ne dosjen e tenderit.

Komisioni ka konstatuar se licenca ka qene e skaduar ne periudhen e njoftimit per kontrate. Konstatimi i komisionit eshte i qendrueshem por komisioni nuk e potencon se z. Ilir Gashi ka qene ne procedure te rregullt te vazhdimit te afatit te licences po ashtu para njoftimit per kontrate. Inxhinieri ne fjale ka poseduar dhe posedon licence ne AKK. Aplikimi per vazhdimin e licences eshte me periudha te limituara sipas rregulloreve, dhe ky sqarim eshte dhene ne detaje ne pergjigjen per sqarime. Mbi te gjitha licenca eshte e nevojsme per aktivitet te ligjshem ne periudhen kur do te behet akativiteti konkrete. Kriteret e vleresimit nga komisioni duhet te merren vetem ato qe jane te shkruara ne FDT, ne kete rast komisioni i vleresimit vetme me qellim te eleminimit te grupit tone del me konstatim dhe arsyetim qe nuk eshte i shkuar ne FDT Pra, komisioni i vleresimit jep arsyetim se licenca e inxh. te gjeodezis ka qene e skaduar ne periudhen e publikimit te njoftimit per kontrate.

Gjithashtu komisioni i vleresimit nuk e merr fare ne konsiderate qe ne kemi ofruar edhe nje tjeter inxh te gjeodezis me Licence z Fjoralb Alla. i njejti ka pasur licence me validitet dhe te njejtit nuk i ndalohet veprimtaria profesionale ne Republiken e Kosoves.

Per me teper do te sqarojme se ne ekspertizen e ekspertit te dates eshte qartesuar shume mire ne ekpsertizen e ankeses nr 422,427/22 te dates 14.09.2022.

PRETENDIMI Nr.9

Lidhur me pretendimin e OE ARHIKO ING O.P" – Prishtinë se GOE ENGIDEA & SIB-BKA SHPK se : Gjeodet të licencuar ka angazhuar Inxhinierin nga Shqipëria F. Alla ku ky inxhinier nuk përbush kërkesat e AK pasi që nuk është i licencuar në Agjensionin Kadastral të Kosovës,

PËRGJIGJEJE NË PRETËNDIMI Nr.9

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE : "ARHIKO ING O.P" – Prishtinë ankues. duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se: në baze të UDHEZIMIT ADMINISTRATIV (MMPH) Nr. 13/2019 PER LICENCIMIN E

KOMPANIVE GJEODETE DHE TË GJEODETËVE si dhe UDHEZIMIT ADMINISTRATIV (MMPH) Nr. 06/2021 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHEZIMIT ADMINISTRATIV nr. 13/2019 PER LICENCIMIN E KOMPANIVE GJEODETE DHE TË GJEODETËVE neni 12. Kompanitë gjeodete të huaja ,

Pika 1. Kompanitë gjeodete të huaja të regjistruara dhe të licencuara jashtë Republikës se Kosovës mund të kryejnë punë dhe shërbime kadastrale në Republikën e Kosovës vetëm në rastin kur janë fitues të tenderit.

Pika 2. Punët dhe shërbimet kadastrale duhet të kryhen vetëm sipas kushteve të kontratës dhe specifikave teknike

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

per te cilen edhe ka marr vendim OSHP-ja. Po ashtu po ju sqarojme se Licenca e gjeodeteve sherben dhe kufizon aktivitetn e matjeve kadastrale dhe nuk ka te beje fare me matjet te reliefit matjet gjeodezike per pune ndertimore.

Po ashtu gjeodeti yne Ilir ashi posedon Licence qe nga 15.02.2017, Licence kjo e para dates se hapje se ofertave. Ne asnje pjese te dosjes se tenderit nuk eshte e theksuar se Licenca e gjeodetit me afat te paskaduar. Eksperienca e gjeodetit te paraqitur nga ana jone eshte deshmuar ne te gjitha format e po ashtu per periudhen qe duhet te zhvilloj aktivitetin tani me per kete objket te kontrates z Ilir Gashi posedon Licencen.

Pretendimi 2:

Eleminimi i grupt tone te OE ENG IDEA shpk & ARCH EMPIRE L.L.C. me arsyetimin per ofrimin e cmimeve jonormalisht te uleta ne dy pozicione per te cilat ka aluduar Komisioni i vleresimit eshte i paqendrueshem. Ne pergjigjen tone te dates 03.10.2023 ne kemi dhene pergjigje te detajuar lidhur me çmimet dhe pergjegjesite tona lidhur me realzimin e sherbimeve. Mbetemi te bindur qe ne kete rast e vetmaj rruge ligjore per llogaritjen e çmimeve jonormailisht te uleta eshte tabela per llogaritjen dhe percaktimin e kushteve per te konsideruar cmimet jonormalisht te uleta. Edhe nje here ju rikutojme se pozicionet per te cilat pretendon AK qe i kemi jonormalsiht te uleta jane poz 2 eshte mbi 100% me i larte se dy ofertuesit e tjere ne gare ndersa poz. 3 eshte 20 % me i larte se dy ofertuesit e tjere ne gare.

Bashkangjitur gjeni tabelen dhe llogaritjen per cmime jonormalisht te uleta e cila eshte plotesisht ne perputhje me ligjin dhe rregulloren per percaktimin e cmimit jonormalisht te ulete e qe AK nuk e merr fare ne konsiderate.

E gjithe kjo per arsye se AK nuk eshte e interesuar te shperbleje me kontrate grupn tone te OE ENG IDEA shpk & ARCH EMPIRE L.L.C. !, sic ka vepruar ne vazhdimisht ne aplikimet e ndermarrjeve tona qofte si konsorcium apo te veteme.

Gjeni tabelen me poshte:

Nr.	Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit - numer prok			
	A	B	C	
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta te pergjegjshme	Pranuar 9 oferta		
2	" PROing&Partners " SH.P.K.,	1	0.83	
3	" STUDIO HAPSIRA " SH.P.K.,	2	0.17	
4	Florije Jahaj,	3	0.23	
5	AL-Engineering shpk -Prishtine	4	0.61	
6	ENG UP SH.P.K.; Enggroup SH.P.K.	5	0.68	
7	GOE: ENG IDE shpk & SIB BKA SHPK	6	0.27	I pergjeg
8	" GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.; Lorenco & Co SH.P.K- Dega ne Kosove; ERVING SH.P.K	7	0.69	
9	Arhiko .ING O.P.; Lekaj.ING SH.P.K.	8	0.44	
10	Instituti I Shkencës Dhe i Teknologjisë Insi SH.P.K.; ALB - Architect SH.P.K	9	80,000.00	
11		Total (3+7+9)	0.88	
12	Merren vetem cmimet e OE te përgjegjshëm	mesatarja (4+7+9)/3	0.29	
13	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	0.23	Ne ketë ra dyte, pranc
14	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta 0.27 € /1.1)	0.25	ne ketë r kushtin e papergjegjs normalisht

Neni 41

Tenderët Jo-normalisht të Ulët

41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktue shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përpu me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontr

41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automa ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë *inter partes* me operatorin përk ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normali ulët.

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e of për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderë përgjegjshëm;

ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të më të ulët;

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuar paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmëri tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposh dhe nenin 61 të LPP-së.

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtim elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

Ne vendimin e OSHP-se nr 422,427/22 per pretendimin e njejet lidhur me cmimet jonormal uleta ka thene:

Sa i përketë pretendimi 3 të parashtruar nga GOE ankues "ENG-IDEA Sh.
SH.P.K, PSH, se AK në fazën e Vlerësimit e po ashtu edhe në atë të Rivler
Operatorin Ekonomik dhe nuk zbaton Nenin 61 të LPP-se për Çmimet jo norm
lidhur me këtë pretendim të ngritur nga GOE ankues obligon AK të zbatoj disp
neni 42 i RRUOPP si dhe ta ketë parasysh nenin 28.15 nga RRUOPP.

Ky pretendim i paraqitur per te marr ne konsiderate çmimet jonormalisht te uleta eshte paraqitur disa here ne OSHP- per te cilen eshte dhene pergjigje dhe eshte kerkuar te zbatohet nga AK. Por

edhe pas rekomadimit te fundit te OSHP-se ne vendimin nr 100,112/23 Ak vendos te zbatoj pjeserisht procesin e percaktimit te cmimit jonormalisht te ulet vetem e vetem per te eleminura grupin tone te OE ENG IDEA shpk & ARCH EMPIRE L.L.C. !, vendose te anuloj proceduren ploteissht, me arsye te paendrueshme.

Kerkojme nga OSHP te shqyrtoj kerkesen tone per rivleresim dhe te anuloj vendimin e dates 23.10.2023 per anulimin e tendrit, te ktej lenden ne rivlersm dhe te urdheroj AK per zbatim te vendimeve te OSHP-se.

Ne si OE ofertues ne kete procedure te prokurimit jemi pale me interes ne kete procedur dhe jemi të përgjegjshem në të gjitha kërkesat e FDT dhe kushteve te tenderit.

Andaj, kerkojme nga OSHP te shqyrtoj Ankesen tone, ta anuloj kete vendim (marr parasysh ligjin dhe RROUPP-ne nenin 47.23 ne baze te te cilit duhet trajtuar) dhe të shpall njoftimin per vendimin e dhenies se kontrates OE te pergjegjshem qe ne kete rast eshte ENG IDEA shpk & ARCH EMPIRE L.L.C.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L-042. për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65.

b) Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit tëKontratës. c) Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.

d) Një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a). Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vuloset në origjinal b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje).

c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, noterizuar nga institucioni kompetent ne vendin tuaj te themelimit).

d). Vërtetimi i tatimit në pronë. Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga

tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzimit të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2. OE duhet të jetë i Regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH-së Kërkesa 3. Regjistrimi i Numrit Fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje).

Dëshmia 2 Certifikata e TVSH-kopje.

Dëshmia 3 Certifikata e numrit fiskal-kopje.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga koha e këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 200.000,00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Pasqyrat financiare të OE, te shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1. Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 130.000,00 €. Kërkesa 2 Në kuadër të stafit duhet të Caktohet a. Menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi i Hidroteknikës ose master i ndërtimtarisë drejtimi Hoidroteknikës - me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion pas diplomimit. Të ketë menaxhuar së paku një projekt të natyrës së kontratës. b. Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi i Hidroteknikës ose master i ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknikes - me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion pas diplomimit. c. . Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv ose master i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv - me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion pas diplomimit. d. Një gjëodet te licencuar nga AKK. me jo më pak se 1 vite përvojë pune në profesion pas diplomimit. Kërkesa 3. Të ketë së paku 3 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. Ne si Autoritet Kontraktues ne pamundësi te ngarkimit te STUDIMIT TE FIZIBILITETIT ne platformën e prokurimit për shkak te madhësisë se tij, ju njoftojmë se mund ta tërheqin STUDIMIN E FIZIBILITETIT ne forme elektronike (me CD-e apo USB).Tërheqja mund te behet çdo dite pune nga ora 8 30 deri

ne ora 15 30 ne zyren e Prokurimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të punëve. Dëshmia 2 a. Duhet te caktohet me vendimi menaxheri i projektit, CV-ia, diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. b, c,- CV-ia, diploma, dëshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë d. Diploma, Licenca e lëshuar nga AKK, dëshmi mbi përvojën në punë kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. Dëshmi 3 Lista e të punësuarve bashkë me përshkrimin e shkurtër te vendit te punës. Për stafin e rregullt, kontratat e punës të skanuar nga origjinali ose kopjet të noterizuar të kontratave . Për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit të skanuar nga origjinali ose kopjet të noterizuar të kontratave për këtë projekt.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Tenderi Anulohet sepse nuk kemi asnje oferte te pergjegjshme.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Vendimi i OSHP-se, me Nr. 422,427/22, i dates: 25.10.2022;

Vendimi i OSHP-se, me Nr. 2023/0112, i dates: 09.06.2023.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ENG IDEA SH.P.K.**

Sqarim hyrës;

Eksperti shqyrtueses sqaron se proceduara e prokurimit me titull: "Hartimi i projektit për kolektorët kryesore te qytetit te Prizrenit", me nr te prokurimit 622-22-2389-221, te iniciuar nga AK- Komuna Prizren, ka qene objekt kontesti disa here ne OSHP, ku Paneli Shqyrtues për pretendimet ankimore te tanishme ka nxjerr vendime dhe pretendimet e njëjta i ka trajtuar si te bazuara.

Përgjigjet ne pretendimet ankimore:

OE ankues ENG IDEA SH.P.K. e konteston njoftimin e AK-se - propozimin për anulim te aktivitetit te prokurimit konkretisht arsyetimin e eliminim, ku AK Komina Prizren, ka potencuar se OE ENG IDEA SH.P.K. me rastin e ofertimit – Licenca e Gjeodetit te z. Ilir Gashit, ka qene e skaduar.

Eksperti shqyrtues, sqaron se për këte qeshtje, AK- Komuna Prizren, tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale ka kërkuar: "Një gjeodet te licencuar nga AKK me jo me pak se një vit me përvojë pune ne profesion pas diplomimit".

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Diplome, Licence e lëshuar nga AKK, dëshmi mbi përvojën e punës".

Operatori Ekonomik ankues ne oferte ka prezantuar me staf kualifikues ku ne mesin e tyre sipas listës ka ofertuar me dy gjeodet për kudër kesaje lidhur me gjeodetin e kontestuar z. Gashi, rezultoi qe i njëjti është gjeodet i licencuar nga Agjencia Kadastrale i Kosovës, ku një gjë e tille konfirmohet sipas listës te gjeodetve te publikuar ne ueb faqen e AKK-se, përveç kësaj z.Gashi rezulton te jete edhe ekspert gjyqësor sipas listës se Këshillit Gjygjesor te Kosovës nga lemia e gjeodezise.

Rrjedhimisht licenca ne AKK ripërtërihet dhe vazhdohet prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues për këtë pike te eliminimit pretendimin e ankimor e ka te bazuar me qe AK Komuna Prizren tek kërkesa apo dëshmia nuk kane kërkuar qe licenca duhet te jete valide ne momentin e dorëzimit te tenderit.

Pretendimi i dyte ankimore:

Lidhure me piken e dyte te eliminimit sa i përket pozicioneve te cilat AK -Komuna Prizren, konsideron se janë si jo normalisht te ulëta eksperti shqyrtues sqaron se AK, për gjate

rivlerësim te ofertave ka kërkuar sqarim nga Operatori Ekonomik, ankues për te njëjtat pozicione, ku OE i ka dhëne sqarimet dhe është zotuar se projektit do te realizohet, ku për ketë qeshje edhe OSHP – Paneli shqyrtues përmes vendimeve paraprake për ketë proceduare te prokurimit për te njëjtin pretendim paneli shqyrtues e ka trajtuar, si pretendim te bazuar dhe AK -ne e ka obliguar qe te beje rivlerësim te ofertave me gjithë atë eksperti shqyrtues vlerësim se rivlerësimi i ofertave nuk është bere ne harmoni me konstatimet dhe me gjetjet paraprake te vendimeve te OSHP-se konkretisht sa i përket ofertës apo pozicioneve te cilave AK konsideron se janë çmime jo normalisht te ulëta, nuk i kane ndjekur rrugët ligjore sipas dispozitave ligjore te nenit 61 te LPP-se, konkretisht nenit 41 paragrafi 2 te Rregullores nr. 001/2022, ku përcakton:

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Përveç asaj qe u përshkrua me larte AK – Komuna Prizren ne dosje te tenderit ka aplikuar masat e sigurimit te ekzekutimit te kontratës, prandaj eksperti shqyrtues edhe ketë pretendim ankimore e kualifikon si te bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ENG IDEA SH.P.K.**

Burim Guri

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA